



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA "ISA BOLETINI"
Ukshin Kovaçica Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

30 maj 2019

Në bazë të nenit 19, pika 1, të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 30.5.2019, mori vendim për të shpallur:

KONKURS
për Rektor të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"

Kandidatët për rektor duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkim shkencor dhe të ketë gradën e profesorit të rregullt, profesorit të asocuar ose profesorit asistent.
2. Të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese universitare.

Procedura e përzgjedhjes:

- Konkurrimi për postin e rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm.
- Zgjedhja e rektorit bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës, si dhe nenit 16 të Rregullores për punën e Këshillit Drejtues.
- Për mospranimin e kandidatëve për pozitën e rektorit, për shkak të konfliktit të interesit aplikohen dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kërkesës për aplikim, kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër,
- Certifikatën e lindjes,
- Vendimin/certifikatën ekuivalente të titullit akademik,
- Përmbledhjen e përvojës akademike (në mësimdhënie, kërkime shkencore, krijimtari artistike) dhe përvojën menaxhuese,
- Dëshminë që nuk është nën hetime.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike duhet të dorëzohen çdo ditë pune, prej orës 09:00-15.30, në Zyrën e arkivit në ndërtesën e Rektoratit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" dhe duhet t'ia adresohen Komisionit profesional të Senatit të Universitetit të Mitrovicës.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike (të skanuara), në adresën konkursi.rektorit@umib.net.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat e shkruara dhe elektronike, përkatësisht nga data 31.5.2019 deri më 14.6.2019, në orën 15.30.

